REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:126305
Datë: 24.02.2020
Numri i dokumentit: 00850103

P.nr. 512/2019
P.nr.769/2019
P.nr.862/2019
P.nr.1088/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues, Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Igballe Azemi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.A, nga Gjilani, për shkak të veprave penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,[1] sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.854/2019 të datës 13.06.2019, PP.II.nr.1368/2019 të datës 06.09.2019, PP.II.nr.1509/2019 të datës 24.09.2019 dhe PP.II.nr.1931/2019 të datës 02.12.2019, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe publik, me datë 20.02.2020, mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari S.A, nga babai R..., nëna R..., e lindur E..., i lindur me ..., në fshatin ..., Komuna e Preshevës, me vendbanim në Gjilan, lagja"..."(...), shqiptar, shtetas i Republikës së Sërbisë, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

I

Sepse më datë 27.10.2018, 22.11.2018 e gjerë më datën 18.12.2018, në kohë të pa përcaktuar, në vazhdimësi në shtëpinë e tij në Gjilan, si konsumator i energjisë elektrike , me qëllim që vetes t'i sjellë përfitime të kundërligjshëm pasuror, pa kompensim ka vjedhur shërbime nga KEDS, në atë mënyrë që pasi punëtorët e autorizuar të KEDS-it, kanë bërë kontrollim tek konsumatori-i pandehuri i lartcekur, kanë vërtetuar se i njëjti ka bërë lidhje direke në rrjetin elektrik, me ç' rast nga kjo lidhje ka furnizuar me energji elektrike pajisje të amvisërisë, me këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme siguron shërbime për të cilat dihet se mundëson vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe në këtë

[1] Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejmë KPRK), nr.06/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013.

2019:126306

mënyrë i pandehuri shmangë pagesën për shërbime të tilla ndërsa të dëmtuarës KEDS - Distrikti në Gjilan i ka shkaktuar dëme material në vlerë rreth 156.00€.

II

Sepse më datë 19.02.2019, në kohë të përcaktuar, në shtëpinë e tij në lagjen në Gjilan, si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes t'i sjellë përfitime të kundërligjshëm pasuror, ka shpenzuar energji elektrike të paautorizuar ashtu që fillimisht njehsori i është shkyçur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-it, mirëpo i pandehuri, pa leje dhe autorizim ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, pa orë matëse , në atë mënyrë i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike, përmes i ka shkaktuar dëme material në vlerë rreth 67.39€.

III

Sepse më datë 20.03.2019, 16.05.2019 dhe 17.05.2019, në kohë të përcaktuar, në shtëpinë e tij në Gjilan si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetes t'i sjellë përfitime të kundërligjshëm pasuror , pa autorizim ka shfrytëzuar energji elektrike ashtu që fillimisht njehsori i është shkyçur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-it, i pandehuri, pa leje dhe autorizim ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, pa orë matëse, në atë mënyrë i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike, përmes të cilave është shpenzuar energjia elektrike në mënyrë të paautorizuar me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike në këtë mënyrë shmangë pagesën e energjisë së shpenzuar edhe kështu e ka dëmtuar KEDS-in Distrikti në Gjilan në vlerë rreth 120.03cent.

IV.

Sepse më 20.04.2019, në Gjilan, me rastin e kontrollimin nga ana e personave të autorizuar të KEDS – it Distrikti në Gjilan, është vërtetuar se si konsumator në Njësorin nr. ..., me paramendim dhe pa autorizim nga Furnizuesi KEDS, Distrikti në Gjilan, përsëri është kyçur në rrjetin elektrik , edhe pse KEDS-i nga distanca ia ka :ç'kyçur njësorin për shkak të mos pagesës së borxhit, ashtu që direkt është kyçur në rrjetin elektrik, jashtë pikës matëse, pa matës së energjisë së shpenzuar, me qëllim që ti shmanget pagesës për energji elektrike të shpenzuar, andaj në atë mënyrë ka gjetur shërbimin për shfrytëzimin e energjisë elektrike për të cilën ai e di se është në dispozicion vetëm në këmbim të pagesës dhe në këtë mënyrë shmangë pagesën e energjisë së shpenzuar edhe kështu e ka dëmtuar KEDS-in Distrikti në Gjilan në vlerë rreth 63.20€.

- Me çka ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës, lidhur me nenin 248 dhe 365 të KPPRK-ës, **të akuzuarin** e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim do ta paguajnë në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

2019:126306

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të paguajë dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20€(njëzet)euro, do ti caktohet një ditë burgim.

Pala e dëmtuar KEDS, për realizmin e kërkesës pasurore udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Detyrohet i akuzuari i që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25€(njëzet e pesë)Euro dhe shumën prej 30€(tridhjetë) euro, në emër të kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë, më datat 13.06.2019, 09.09.2019, 03.12.2019 dhe 26.09.2019, ka dorëzuar aktakuzat me numër PP.II.nr.854/19, PP.II.854/2019 të datës 13.06.2019, PP.II.nr.1368/2019 të datës 06.09.2019, PP.II.nr.1509/2019 të datës 24.09.2019 dhe PP.II.nr.1931/2019 të datës 02.12.2019, kundër të pandehurit S.A, për shkak të veprës penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafin 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata me aktvendim procedural ka bashkuar lëndët penale P.nr.512/19 me numër të aktit akuzës PP.II.nr 854/19, të datës 13.06.2019, P.nr.769/2019 me numër PP.II.nr.1368/2019 të datës 06.09.2019, lëndën penale P.nr.862/2019 me numër të aktit akuzës PP.II.nr.1509/2019 e datës 24.09.2019, si dhe lëndën penale P.nr.1088/19 me numër PP.II.nr.1391/2019 të datës 02.12.2019

Me datë 12.02.2020, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu[2], dhe i akuzuari S.A, në të cilën seancë pas leximit të dispozitivit të aktakuzës nga ana e prokurores, i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit të lartcekur për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranonte fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmbajnë aktakuzat dhe se aktakuzat nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

[2] E ka bërë rikualifikim e veprave penale, në veprën penale vjedhje e shërmbimeve në vazhdim, ngase plotësohen kushtet ligjore.

2019:126306

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari S.A ka kryer veprat penale, vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit edhe atë dënim me gjobë në shumë prej 200€, ka konsideruar se duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës, ashtu që për të akuzuarin, si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, se i njëjti është penduar dhe i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, ndërsa si rrethanë renduese ka marrë për bazë qëllimin e të akuzuarit, si dhe në kohën e fundit kjo vepër penale është në rritje.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38, të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprës penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim efektiv.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë t' a paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 25€, si dhe shumën prej 30€, në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim te merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar KEDS nga Gjilani për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil, konfrom nenit 463 të KPP-ës.

2019:126306

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr. 512/2019, P.nr.769/2019, P.nr.862/2019, P.nr.1088/2019
Me datë: 20.02.2020

Sekretarja Juridike,
Igballe Azemi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.

2019:126306